

**Një udhëzues për t'ju
ndihmuar të përdorni
shërbimin tuaj lokal të GP-së** të kujdesesh
për trupin, zemrën dhe mendjen tënde



Krijuar nga refugjatët për refugjatët

Për cilat probleme mund t'ju ndihmojë mjeku juaj i përgjithshëm (GP)?

Infermierët dhe mjekët në klinikën tuaj lokale të GP-së mund t'ju ekzaminojnë, t'ju këshillojnë dhe t'ju trajtojnë për t'ju ndihmuar të mbanit trupin, zemrën dhe mendjen tuaj të shëndetshme. Ata ju ndihmojnë me:

- Dhimbjet dhe dëmtimet fizike të vazhdueshme, stresin, trishtimin dhe vetminë, ankthin, problemet e lëkurës, problemet me drogën dhe alkoolin dhe problemet me fryshtim
- Sigurimin e recetave përmes mjekimeve
- Dhënien e referencave përmes shërbimeve të tjera shëndetësore dhe sociale, siç janë klinikat spitalore përmes problemeve serioze dhe shërbimit i specializuar i shëndetit mendor
- Bërjen e vaksinave dhe sigurimin e kontraceptivëve
- Kujdesi ndaj nënave dhe foshnjave si dhe kontrolllet shëndetësore të fëmijëve



Si mund të keni qasje tek GP juaj?

1. Regjistrimi tek GP-ja juaj

Merrni një formular regjistrimi nga GP-ja lokal dhe plotësojeni në shtëpi ose kërkonit ndihmë tek klinika. Disa klinika ofrojnë regjistrimin online.



2. Rezervimi i një takimi

Vizitonit faqen e internetit të klinikës së GP-së, telefononi recepcionin përpëra orës 9:00 ose përdorni Aplikacionin NHS. Ju duhet të thoni:

- Emrin dhe datën e lindjes
- Pse duhet të vizitonit GP-në
- Nëse problemi juaj është urgjent
- Nëse keni nevojë për një takim telefonik ose takim ballë për ballë
- Kur të jeni të lirë

Disa klinika përdorin formularë online për të rezervuar takimet. Nëse nuk mund të përdorni formularin online, atëherë mund të telefononi recepcionin.

3. Pjesëmarrja në takim

Sigurohuni që të mbërrini 5 minuta para takimit tuaj. Do t'ju kërkohet të uleni në dhomën e pritjes dhe do t'ju thërrasin kur mjeku të jetë gati.

Marrja e ilaçeve

Pjesëmarrja në takime në një shërbim tjeter

Kujdesi për veten

5. Pas takimit

Është e rëndësishme të ndiqni këshillat ose planin e trajtimit nga mjeku.

Kryerja e analizave të gjakut


Marrja e recetave nga farmacia

Mjeku do t'ju japë një formular me udhëzime për analizën tuaj të gjakut. Kontrolloni nëse duhet të mos hani ushqim përpëra kryerjes së analizës.

Sigurohuni që të kontrolloni nëse duhet të merrni një recetë të printuar për në farmaci apo nëse mjeku do e dërgojë recetën tuaj në një farmaci të caktuar.

4. Biseda me GP-në

Takimi juaj do të zgjasë 10 minuta. Jini të gatshëm t'i tregoni mjekut të përgjithshëm (GP) problemin tuaj dhe për sa kohë e keni pasur këtë problem. Përpinquni të flisni fillimisht për problemin më të rëndësishëm dhe sigurohuni që ta keni kuptuar plotësisht planin e trajtimit para se të largoheni.



Cilat janë të drejtat tuaja të

Është e rëndësishme që të jeni të vetëdijshëm për të drejtat tuaja të kujdesit shëndetësor. Të drejtat e mëposhtme mbrohen nga politikat e NHS (Shërbimi Shëndetësor Kombëtar):

1. Ju nuk keni nevojë të tregoni dëshmi për adresën ose statusin e imigracionit për t'u regjistruar tek GP.
2. Nëse një GP refuzon të pranojë regjistrimin tuaj, ata duhet të japid arsyet me shkrim.
3. Ju keni të drejtë të ankoheni kundër diskriminimit nëse GP-ja nuk pranon t'ju regjistrojë pa ndonjë arsyе të vlefshme.
4. Ju mund të ndryshoni mjekun ose klinikën pa dhënë ndonjë arsyе.
5. Ju mund të kërkonit një mjek, infermier ose përkthyes mashkull ose femër.
6. GP-ja duhet të përdorë një përkthyes profesional nëse nuk mund të kuptoni ose flisni anglisht aq mirë sa të dini se çfarë trajtimi po ju jep doktori.
7. Ju keni të drejtë të kërkonit një përkthyes tjetër nëse nuk jeni të kënaqur me shërbimin.
8. Trajtimi tek mjeku i përgjithshëm (GP) është pa pagesë.
9. Ju keni të drejtë të refuzoni trajtimin.
10. Ju keni të drejtë të ankoheni nëse mjeku i përgjithshëm (GP) nuk ndjek rregullat dhe politikat e mësipërme.

A mund t'i besoni mjekut tuaj të përgjithshëm GP?

GP-ja është një shërbim konfidencial. Kjo do të thotë që gjithçka që i tregoni mjekut të përgjithshëm mbahet e fshehtë, përfshirë të dhënat tuaja personale dhe të dhënat mjekësore. GP-së nuk i lejohet të tregojë askujt pér ju pa lejen tuaj përveç rasteve kur:

- ju mungon aftësia pér të dhënë pëlqimin tuaj
- kërkohet me ligj ose urdhërohet nga gjykata
- nëse ju ose një person tjetër jeni në rrezik vdekjeje ose dëmtimi serioz

A duhet të ndani informacione pér jetën tuaj me mjekun e përgjithshëm GP?

Nuk është gjithmonë e lehtë të bësh bisedë në lidhje me përvojat e kaluara me mjekun tënd të përgjithshëm GP. Veçanërisht kur nuk e njihni shumë mirë.

Disa persona konsiderojnë se ndarja e detajeve pér jetën e tyre ndihmon mjekun e përgjithshëm GP të ofrojë kujdes më të mirë.

Sidoqoftë, është në rregull nëse zgjidhni të mos ndani detaje rreth jetës tuaj me mjekun e përgjithshëm GP, edhe nëse ata ju pyesin.

Sido që të jetë, mjeku juaj i përgjithshëm GP do të jetë i gatshëm t'ju dëgjojë nëse doni të flisni me ta.

Është e rëndësishme të mbani mend se është gjithmonë në rregull të kérkonit ndihmë dhe të qenit të hapur e të singertë është mënyra më e mirë pér të marrë mbështetjen që meritoni.

Si mund t  i p rgatiteni p r nj  vizit  tek mjeku i p rgjithsh m GP?

- Mendoni paraprakisht se  far  doni t  i thoni
- Ju mund t  d shironi t  ftoni nj  an tar t  familjes ose nj  mik p r mb shtetje
- P rqendrohuni n  at  se si jeni ndjer  gjat  muajve t  fundit
- P rdorni fjal t q  kan  kuptim p r ju p r t  p rshkruar p rvojat tuaja
- Sigurohuni q  t  kuptoni se  far  po thot  mjeku
- Merrni di ka p r t  mbajtur sh nime



A duhet t  i tregoni mjekut t  p rgjithsh m GP n se ndiheni t  shqet suar, t  trishtuar apo e keni t  v shtir  ta p rballoni?

Mjeku juaj i p rgjithsh m GP mund t  ju ofroj  mb shtetje p r t  p rmir suar mir genien tuaj n se keni shqet sime t  vazhdueshme, trishtim ose izolim.

Mund t  jet  e v shtir  t  flas sh p r k to lloj p rvojash, por t  ndash me GP se si ndihesh mund t  jet  hapi i par  p r t  gjetur mb shtetje.

Mos harroni, asnj  problem nuk  sht  shum  i vog l ose i par nd sish m p r t  merituar ndihm .



A keni pasur një përvojë të keqe në recepcion?

Bashkëveprimi me recepcionin mund të jetë sfidues për disa arsy. Më poshtë janë renditur pesë problemet e zakonshme që pacientët kanë në recepcion:

Receptionisti nuk jep një përgjigje të dobishme në pyetjen tuaj.



Receptionisti nuk ka kohë t'ju japë vëmendjen që ju nevojitet.

Receptionisti është i vrazhdë ose jo mirëpritës ndaj jush.

Ju jeni të pakënaqur me kohën e takimit ose mjekun që ju kanë rezervuar të takoni.

Keni vështirësi në komunikimin me receptionistin nga telefon.

Receptionisti mund të mos e ketë kuptuar problemin tuaj. Përsërisni ngadalë fjalët tuaja, kérkonit të shkruani problemin tuaj, përdorni një aplikacion përkthimi ose kérkonit një përkthyes.

Pyesni se kur mund të vini për të biseduar me një anëtar të stafit.

Qëndroni të qetë dhe përsërisni pyetjen tuaj, tregoni se e kuptoni që receptionisti është e zënë. Nëse ky problem vazhdon, ju mund të ankoheni tek menaxheri i praktikës.

Ju mund t'i kérkonit receptionistit një orar tjetër takimi, një mjek ose infermiere tjetër.

Ju mund të kérkonit një përkthyes, të dërgoni një email ose të kérkonit të shkoni në klinikë për të folur me receptionistin.

Shërbimet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë nëse keni probleme me qasjen tek mjeku i përgjithshëm GP apo me kujdesin që merrni. Ju gjithashtu mund të flisni me punëtorin tuaj të çështjes ose me menaxherin e praktikës në klinikën e GP.

Migrant Help - 0808 8010 503
www.migranthelpuk.org

The Patients Association - 0800 345 7115
www.patients-association.org.uk

Refugee Council - 0808 196 7272
www.refugeecouncil.org.uk

CITY
UNIVERSITY OF LONDON
EST 1894



SUPPORTING AND
EMPOWERING
REFUGEES